



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 78/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) të dt. 27.05.2014 lidhur me emërimin e kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), në seancën e panelit të mbajtur me 29.05.2014, mori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET apeli** i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), **si i bazuar.**
- II. **ANULOHET** vendimi i Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), i datës 27.05.2014, lidhur me emërimin e kryesuesve të KVV-ve në komunën e Mamushës dhe çështja kthehet në rishqyrtim.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel nga subjekti politik KTAP paraqitur kundër vendimit të KQZ-së të dt. 27.05.2014, lidhur me emërimin e anëtarëve dhe kryesuesve të KVV-ve në komunën e Mamushës, ku sipas parashtruesit të ankesës për kryesues të KVV-ve janë emëruar vetëm anëtarët nga subjekti politik KDTP e jo edhe nga subjektet e tjera politike. Parashtruesi i ankesës dyshon se këto veprime janë lojë e kryetarit të KDTP Mahir Yagcilar dhe përfaqësuesit të KDTP-së në KQZ Ercan Spat, pasi që në zgjedhjet e fundit lokale 2013 KTAP ka dalë si partia më e votuar e komunitetit turk. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon sqarime rreth mënyrës së emërimit të kryesuesve dhe shpreh dyshimet se si ka mundur që në një qendër të votimit të gjithë kryesuesit të jenë nga vetëm një subjekt politik konkretisht nga subjekti politik KDTP.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 28.05.2014, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit deri më datë 29.05.2014 deri në ora 10:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja, në të cilën theksohet se në rastin konkret KQZ-ja nuk ka mundur ti ndaj subjektit politik KTAP në Mamushë asnjë vend të kryesuesit për arsye se nuk ka qenë subjekt politik i certifikuar për zgjedhjet parlamentare 2010.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

apeli është i bazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të subjektit politik KTAP, janë të bazuara pasi që neni 77.3 i LZP-së përcakton qartë që kryesuesit e këshillave të vendotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Parlamentin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë, prandaj me këtë rast KQZ në kundërshtim me nenin 77.3 të LZP-së, ka bërë emërimin si kryesues të KVV-ve vetëm përfaqësuesit nga radhët e subjektit politik KDTP-së.

KQZ-ja, në këtë rast nuk e ka zbatuar drejt dispozitën e lartpërmendur meqenëse të gjithë kryesuesit e vendotimeve në komunën e Mamushës janë emëruar vetëm nga një subjekt politik ndërsa nga shkresat e lëndës PZAP-i ka konstatuar se ka pasur edhe subjekte tjera politike nga ajo komunë që kanë fituar vota dhe që kanë qenë të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës në Zgjedhjet Parlamentare 2010.

Prandaj emërimet e tilla të këtyre kryesuesve janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 77.3 të LZP-së, kështu që PZAP-i, në kuptim të nenit 118 par. 1 të LZP-së, nenit 11.8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, lidhur me nenin 209 pika (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 78/2014 më datën 29.05.2014.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shata



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*